

ARSIMI SHQIP NË KOSOVË GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE  
1914-1918

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE

EKSPOZE E TEMES MASTER

NGA

VESA OSMANAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PRISHTINË

Mars, 2022

# ARSIMI SHQIP NË KOSOVË GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE 1914-1918

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Kandidate: Vesa Osmanaj

Kur bëhet fjalë për gjendjen e përgjithshme të arsimit në gjuhën shqipe, gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë, mund të thuhet se shkollat shqipe, gjatë kësaj kohe, nuk mund të kishin fat më të mirë nga ai që kishte dhe vetë populli i këtyre trevave shqiptare, gjatë periudhës kohore 1914-1918.

Ky punim është i përbër nga tre kapituj, për të cilët jam mundur që të bëjë analizën dhe të trajtoj ato materiale të cilat kisha mundësi: libra, artikuj të shtypit “ Shkëndija”, “Vjetarin”, “Kosova”, “Studime Historike”, dokumente arkivore, buletin e fakulteteve në Kosovë dhe Shqipëri etj. Për këtë periudhë të rëndësishme të arsimit shqip në Kosovë kanë shkruar studiues të ndryshme si: Jashar Rergjepaqiq, Sulltane Kojçini – Ukaj, Hajrullah Koliq, Bajram Shatri, Metë Shatri, Shefki Osmani etj.

Duke e ditur pushimi që kishte Kosova nga sebo- malvezet, kryengritje e vitit 1913-1914, të gjitha këto e bënë jetën ende më të rënduar për popullin dhe për zhvillimet kulturore dhe arsimore në Kosovë. Para së të fillonte Lufta e Parë Botërore gjendja arsimore dhe kulturore ishte në gjendje shumë të rëndë ku popullsia u nda të bazë të perkatësis fetare që i takonte, myslihanet ishin të detyra më dhunë që femijet e tyre ti dergonin në kishë për t’i pagezuar. Në gjendje shumë të rëndë ishin dhe gratë të cilat nuk kishin as një rol me rëndës përveç atyre punëve të shtëpis dhe të punoni në fushë.

Përpjeket për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë gjatë kësaj kohe kishin bërë shumë atdhetari Bajram Curri, Hasan Prishtina, të cilët ishin idhtar të mëdhej të arsimit shqip në Kosovë. Shkolla e parë shqipe në Gjakovë është hapur me angazhimi e Bajram Currit, kjo kishte ndodhur pak ditë para ardhjes së ushtrisë austro-hungareze. Mësuesit klasorë dhe mësime të lëndëve të ndryshme të shkollave të rrethit të Gjakovës kanë qenë kryesisht nga *Normalja e Beratit*, por ka pas edhe nga të cilët kishin kryer shkollën *Idadije* të Shkupit.

Përveç shkollës shqipe që ishte hapur në Gjakovë, suksese të dalluar kishin pasur edhe shkollat e Pejës dhe të Mitrovicës, kurse në Prizren nuk kishte ndonjë aktivitet të dalluar, sepse ajo ishte zonë e pushtimit bullgar, sipas marrëveshjes së të dy pushtuesve, lejohej vetëm qarkullimi i ushtrisë austro-hungareze, vazhdimi i punës së shkollave ekzistuese, por jo dhe hapja e shkollave të reja.